

"(3) Доколку работодавачот во рокот од ставот (2) на овој член не ги отстрани утврдените незаконитости инспекторот за труд ќе донесе времено решение за забрана на работа во работната просторија на работодавачот во траење од 60 дена.

(4) Против решението од ставовите (2) и (3) на овој член работодавачот може да изјави жалба до министерот надлежен за работите од областа на трудот.

(5) Жалбата не го одлага извршувањето на решението.

Ставот (3) станува став (6).

Ставот (4) се брише.

Ставот (5) станува став (7).

Член 14

Во членот 264 став (1) износот "7.000" се заменува со износите "6.000 до 7.000".

Во точката 4 точката на крајот на реченицата се брише и се додаваат зборовите: "(членови 256 став (1) и 257 став (1))".

Во ставот (2) износот "4.000" се заменува со износите "3.000 до 4.000".

Во ставот (3) износот "5.000" се заменува со износите "4.000 до 5.000".

Член 15

Во членот 265 став (1) износот "3.000" се заменува со износите "2.000 до 3.000".

Во ставот (1) точката 1 се менува и гласи:

"1) договорот за вработување не се чува во работните простории во седиштето на работодавачот и не му е врачен примерок од договорот за вработување на работникот (член 15 ставови (2) и (3));".

Во ставот (2) износот "1.000" се заменува со износите "500 до 1.000".

Во ставот (3) износот "2.000" се заменува со износите "1.000 до 2.000".

Член 16

Во членот 265-а став (1) износот "1.000" се заменува со износите "500 до 1.000", а во точката 8 зборот "да" се заменува со зборовите: "а не".

Во ставот (2) износот "500" се заменува со износите "300 до 500".

Во ставот (3) износот "800" се заменува со износите "600 до 800".

Член 17

Во членот 266 став (1) износот "1.200" се заменува со износите "1.000 до 1.200".

Член 18

Се задолжува Законодавно-правната комисија при Собранието на Република Македонија во рок од 30 дена од денот на објавувањето на овој закон да утврди пречистен текст на Законот за работните односи.

Член 19

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MARRËDHËNIE PUNE

Neni 1

Në Ligjin për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10 dhe 47/11), në nenin 5 paragrafi (1) pika 8 si vijon:

"8. "Orar i punës" është koha në të cilën punëtori punon dhe i kryen punët dhe detyrat e veta të punës, në pajtim me ligjin, marrëveshjen kolektive dhe marrëveshjen për punësim;".

Neni 2

Në nenin 15 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Marrëveshja për punësim ruhet në lokalet e punës në selinë e punëdhënësit."

Neni 3

Në nenin 63 paragrafi (1) pas fjalëve: "e tij" shtohet fjala "originale".

Neni 4

Neni 102 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Krahas kthimit në punë, punëdhënësi detyrohet që punëtorit t'ia paguajë rrogën bruto që do ta merrte po të ishte në punë në pajtim me ligjin, marrëveshjen kolektive dhe marrëveshjen për punësim, të zvogëluar për shumën e të hyrave që punëtori i ka realizuar në bazë të punës, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës."

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (5) që bëhet paragraf (4), ndryshohet si vijon:

"(4) Nëse gjykata me vendim të plotfuqishëm konstaton se punëtorit në mënyrë të paligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës, e për punëtorin nuk është e pranueshme që të mbetet në marrëdhënie pune, gjykata me kërkesë të punëtorit do ta caktojë ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe do ta ngarkojë punëdhënësin që punëtorit t'ia paguajë rrogë në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni."

Paragrafët (4), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (3), (5) dhe (6).

Neni 5

Në nenin 110 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Punëdhënësi detyrohet që punëtorit t'ia paguajë rrogën në mënyrën e përcaktuar me ligj."

Paragrafi (2) shlyhet,

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (2) dhe (3).

Neni 6

Në nenin 117 paragrafi (6) pas fjalës "vendosje" shtohen fjalët: "dhe kryerje", ndërsa në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "në afat prej tri ditëve të punës nga vendosja e punës jashtë orarit."

Neni 7

Në nenin 145 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Punëtori ka të drejtë për kompensim të pjesës së pashfrytëzuar të pushimit vjetor para ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nëse paraprakisht ka kërkuar shfrytëzim të pushimit vjetor, e nuk i është mundësuar shfrytëzimi i pushimit vjetor, ndërsa marrëdhënia e punës i është ndërprerë pa fajin dhe vullnetin e tij."

Neni 8

Në nenin 189 paragrafi (1) shlyhet.

Paragrafi (2) bëhet paragraf (1).

Neni 9

Në nenin 210 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Kur parashtrohet kërkesë për përcaktimin e reprezentativitetit, e nuk janë plotësuar kushtet për reprezentativitet nga nenet 212 paragrafët (1) pika 2 dhe (2), (3) dhe (4) dhe 213 paragrafët (1) pika 2, (2) dhe (3),

në aspekt të përqindjes së anëtarëve, deri në plotësimin e kushteve për përqindjen e anëtarëve dhe përcaktimin e reprezentativitetit, marrëveshje kolektive lidhin punëdhënësi ose shoqata e punëdhënësve dhe sindikata që ka numër më të madh të anëtarëve, në bazë të listës së dorëzuar me kërkesën për përcaktimin e reprezentativitetit.

(3) Marrëveshja kolektive në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, lidhet pas marrjes së njoftimit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale te sindikata, përkatësisht punëdhënësit, të cilët dorëzojnë kërkesë për përcaktimin e reprezentativitetit, për sindikatën përkatësisht punëdhënësit, që ka numër më të madh të anëtarëve."

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Neni 10

Pas nenit 213-a shtohet titull i ri "Përbërja dhe mënyra e punës së Komisionit" dhe nen i ri 213-b, si vijojnë:

"Përbërja dhe mënyra e punës së Komisionit

Neni 213-b

(1) Komisioni përbëhet prej nëntë anëtarësh, prej të cilëve nga një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë, tre përfaqësues emërojnë shoqëritë reprezentative të punëdhënësve dhe tre përfaqësues sindikatat reprezentative, anëtarë të Këshillit Ekonomik Social.

(2) Sindikatat e regjistruara dhe shoqatat e punëdhënësve në nivel nacional mund të caktojnë përfaqësues të tyre, që do të jetë i pranishëm gjatë punës së Komisionit.

(3) Përfaqësuesit e ministrive nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit kompetent për çështje nga sfera e punës.

(4) Punët administrative-profesionale për punën e Komisionit i kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(5) Mënyra e punës së Komisionit përcaktohet me Rregulloren e punës së Komisionit."

Neni 11

Në nenin 213-v paragrafi (2) pika 2 fjalët: "dhe fletëregjistrime të anëtarëve" shlyhen.

Neni 12

Në nenin 258-a paragrafi (1) numri "219-v" zëvendësohen me numrin "213-v".

Neni 13

Në nenin 259 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Nëse punëdhënësi nuk vepron sipas aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori i punës do të miratojë aktvendim të përkohshëm për ndalim të punës në lokalet e punës të punëdhënësit në kohëzgjatje prej 15 ditësh."

Pas paragrafit (2) shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5), si vijojnë:

"(3) Nëse punëdhënësi në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk i mënjanon parregullsitë e konstatuara, inspektori

i punës do të miratojë aktvendim të përkohshëm për ndalim të punës në lokalet e punës të punëdhënësit në kohëzgjatje prej 60 ditësh.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, punëdhënësi mund të paraqesë ankesë te ministri kompetent për çështje nga sfera e punës.

(5) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit."

Paragrafi (3) bëhet paragrafi (6).

Paragrafi (4) shlyhet.

Paragrafi (5) bëhet paragraf (7).

Neni 14

Në nenin 264 paragrafi (1) shuma "7 000" zëvendësohen me shumat "6 000 deri në 7 000".

Në pikën 4 pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "(nenet 256 paragrafi (1) dhe 257 paragrafi (1))".

Në paragrafin (2) shuma "4 000" zëvendësohen me shumat "3 000 deri në 4 000".

Në paragrafin (3) shuma "5 000" zëvendësohen me shumat "4 000 deri në 5 000".

Neni 15

Në nenin 265 paragrafi (1) shuma "3 000" zëvendësohen me shumat "2 000 deri në 3 000".

Në paragrafin (1) pika 1 ndryshohet si vijon:

"1) marrëveshja e punësimit nuk ruhet në lokalet e punës në selinë e punëdhënësit dhe nuk i dorëzohet ekzemplari i marrëveshjes së punësimit të punëtorit (neni 15 paragrafët (2) dhe (3));".

Në paragrafin (2) shuma "1 000" zëvendësohen me shumat "500 deri në 1 000".

Në paragrafin (3) shuma "2 000" zëvendësohen me shumat "1 000 deri në 2 000".

Neni 16

Në nenin 265-a paragrafi (1) shuma "1 000" zëvendësohen me shumat "500 deri në 1 000", ndërsa në pikën 8 fjala "të" zëvendësohet me fjalët: "e nuk".

Në paragrafin (2) shuma "500" zëvendësohen shumat "300 deri në 500".

Në paragrafin (3) shuma "800" zëvendësohen shumat "600 deri në 800".

Neni 17

Në nenin 266 paragrafi (1) shuma "1 200" zëvendësohen me shumat "1 000 deri në 1 200".

Neni 18

Obligohet Komisioni Juridiko-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së këtij ligji, të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për marrëdhënie pune.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".